



Pranuar / Dostiguar Priljeno / Podato Received / Delivered	04.01.2024	4	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHUKA	49/2024		112



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1504/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1504/2023 të datës 08.12.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet *jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1504/2023 të datës 08.12.2023 të parashtruar nga ankuesi
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Komunën e Fushë Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 08.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit Nr.prot.7371/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit Komuna e Fushë Kosovës, lidhur me kategorizimin e tij në pozitën e punës „Teknik Administrativ” me koeficient tre pikë tetë (3.8).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi është i emëruar sipas Akt Emërimit me numër 231 të datës 15.03.2012 në pozitën e punës „Nëpunës për Ujësjellës dhe Kanalizim” në kuadër të drejtorisë për Shërbime Publike në Komunën e Fushë Kosovës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e marrëdhënies se punës të ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 5 paragrafi 5 ku përcaktohet se: **5". Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike"**, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Akt Emërimin me numër 231 të datës 15.03.2012 për pozitën e punës „Nëpunës për Ujësjetllës dhe Kanalizim“ Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita „Nëpunës për Ujësjetllës dhe Kanalizim“, te cilën ankuesi e mbanë aktualisht hynë në kategorinë e **Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës** gjegjësisht i njëjti nuk e ka statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, por e gëzon statusin e **Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës**, sikurse përcaktohet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, theksuar si më sipër meqenëse ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1504/2023 të datës 08.12.2023 të parashtruar nga ankuesi

Rrjedhimisht, në zbatim të dispozitave të nenit 88 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos që kjo lenë t'i bartet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Komunën e Fushë Kosovës .

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1504/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

